





REPUBLIKA E KOSOVËS / RÉPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO		
		
Përcaktim dhe funksionim Republic of Kosovo		
Oda e infermierëve, mësuesve dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës Komora medicinskich sestrara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova Chamber of nurses, midwives and other health professionals of Kosovo		
ARXIV / ARCHIV / ARCHIVE		
Nr. Prot. Broj. prot. Prot. no.	Nr. i faq. Br. str. No. page	Data: Datum Date:
596	-4-	25.06.2019



MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

Në mes të

Odës së Infermierëve të Kosovës – OIK

Dhe

OJQ Kasnecët e Ardhmërisë - KeA

për

Bashkëpunim në kuadër të edukimit të vazhdueshëm profesional për profesionistët shëndetësor/ infermierë, me qëllim të përmirësimit të kualitetit dhe standardizimit të shërbimeve shëndetësore në fushën e parandalimit, trajtimit dhe kujdesit për TB në Kosovë

DUKE PASUR PARASYSH qëllimin Organizatës Joqeveritare, "Kasnecët e Ashmërisë" – KeA, për të bashkëpunuar me Odën e infermierëve, me qëllim të zhvillimit profesional të infermierëve për ofrimin e shërbimeve shëndetësore parandaluese, diagnostikuese, trajtuese dhe rehabilituese për të afektuarit nga TB, sipas standardeve bashkëkohore dhe praktikave të mira; dhe

DUKE PASUR PARASYSH qëllimin e Odës së infermierëve për të siguruar arsimin të vazhdueshëm profesional cilësor për infermierët në bazë të metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe zhvillimit të shkathësive profesionale praktike;

Palët pajtohen si në vijim:

Neni 1

Qëllimi i këtij Memorandumi

1.1 Ky Memorandum i Mirëkuptimit ka për qëllim të vendosë një bashkëpunim në mes të Odës së Infermierëve të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: OIK) dhe Organizatës Joqeveritare, Kasnecët e Ardhmërisë (në tekstin e mëtejshëm: KeA), për zbatimin e aktiviteteve në kuadër të Programit për TB të përkrahur nga Fondi Global për Aids, Malaria dhe TB.

1.2 Përmes këtij memorandumi do të arrihet planifikimi dhe zbatimi i moduleve të trajnimeve në kuadër të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional për profesionistë shëndetësor/infermierë, zbatimin e standardeve dhe praktikave më të mira në kuadër të Programit të TB, për ngritjen e kapaciteteve të stafit infermierik në diagnostikimin, trajtimin dhe menaxhimin e rasteve të TB dhe avokimin për TB në kuadër të Programit Kombëtar të kontrollit të TB.

1.3 Përmes këtyre aktiviteteve synohet përmirësimi i qasjes në shërbime cilësore për parandalimin, trajtimin dhe kujdesin për TB; përmirësimi i raportimit të rasteve dhe krijimi i një ambienti përkrahës, që ofron qasje të barabartë në shërbimet shëndetësore për personat që jetojnë me TB në Kosovë dhe për popullatat kyçe në nevojë.

Neni 2

Oda e Infermierëve të Kosovës

- 2.1 OIK do të inkorporojë në programin për zhvillim të vazhdueshëm profesional infermierik trajnimet dhe modulet e sipër përmendura në bazë të planit të miratuar të trajnimeve për TB, në kuadër të Programeve Kombëtare për TB.
- 2.2 OIK synon të bashkëpunoj me KeA në përmirësimin e standardeve të kujdesit dhe zbatimin e tyre në shërbimet shëndetësore në nivel kombëtar.
- 2.3 OIK do të ofrojë mbështetje në organizimin dhe thirrjen e trajnimeve sipas mundësive dhe marrëveshjeve me KeA.
- 2.4 OIK do të akreditojë trajnimet nga planet e trajnimeve të Programeve për TB sipas rregulloreve të OIK.
- 2.5 OIK në bashkëpunim me KeA do të bëjë mbikëqyrjen e trajnimeve të sipër përmendura.
- 2.6 OIK do të ofrojë listën e trajnerëve kompetent të lëmive për trajnimet e organizuara nga OJQ KeA,

Neni 3

Obligimet e KeA

- 3.1 KeA do të ofrojë përkrahje teknike dhe profesionale OIK-së për planifikimin dhe implementimin e moduleve të trajnimeve për profesionistët shëndetësor/infermierë në kuadër të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të planeve të trajnimit të Programit për TB.
- 3.2 KeA do të mundësojë anagazhimin e trajnerëve kompetent sipas procedurave të parapara në manualin e saj dhe konform dispozitave ligjore përmes procedurave të konkursit të hapur.
- 3.3 KeA do të sigurojë trajnime për anëtarët e OIK, të cilët janë të punësuar në institucionet shëndetësore që merren me kontrollin e TB.
- 3.4 KeA përmes granteve të Fondit Global do të mbështesë financiarisht dizajnimin e moduleve dhe zbatimin e trajnimeve sipas planeve të miratuara duke përfshirë edhe shpenzimet për trajnues dhe shpenzimet logjistike rreth organizimit.
- 3.5 KeA synon që trajnimet dhe modulet të dizajnohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve, për mbrojtjen e të dhënave personale dhe mos-diskriminim.
- 3.6 KeA do të jetë në konsultim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me OIK përgjatë zbatimit të këtij memorandumi.
- 3.7 Varësisht nga ndryshimi i rrethanave ky memorandum mund të revidohet me pëlqimin e dyja palëve.

Neni 4

Zbatimi

4.1 Palët pajtohen se do të përkujdesën për zbatimin me përkushtim dhe përpikëri të kësaj marrëveshje.

Neni 5

Vlefshmëria kohore

5.1 Palët nënshkruese u pajtuan që vlefshmëria kohore e këtij memorandumi të mbetet në fuqi deri në momentin e përfundimit të Programeve të TB të mbështetura nga Fondi Global.

5.2 Palët do të shqyrtojnë vazhdimësinë e bashkëpunimit edhe në periudhën e tranzicionit përtej mbështetjes nga Fondi Global.

5.3 Palët nënshkruese ruajnë të drejtën e tërheqjes nga kjo marrëveshje me paralajmërim paraprak me shkrim prej së paku 30 ditë.

Neni 6

Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

5.1 Marrëveshja është nënshkruar në dy (2) kopje identike origjinale, nga një (1) kopje për secilën palë nënshkruese dhe e njëjta hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dy palët.

Për Odën e Infermierëve të Kosovës:



Nënshkruar me datë _____

Për OJQ KeA:



Në: _____
25.06.2019